

SYLLABUS: Kontabilitet Financiar

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Kontabiliteti Financiar
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti II-të, semestri IV-të
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	5 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Skender Ahmeti; Nexhmie Berisha
Detajet kontaktuese:	skender.ahmeti@uni-pr.edu ; nexhmie.berisha@uni-pr.edu ;
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë është e dizajnuar për të siguruar një kuptim themelor, si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik, lidhur me kontabilitetin e pasurive afatgjata, kontabilitetin e detyrimeve afatshkurtëra dhe afatgjata, financimin e korporatës përmes borxhit (obligacionet), financimin e korporatës përmes kapitalit (aksionet), kontabilitetin e shoqërive partnere (ortakëritë) si dhe ndërtimin dhe interpretimin e pasqyrës së rrjedhës së parasë me dy metodat.
Qëllimet e lëndës	Lënda ka për qëllim sigurimin e përfitimit të njohurive më të thella nga fusha e kontabilitetit financiar, të kuptohet se njohja dhe vlerësimi i detyrimeve ndikon në vlerësimin e rentabilitetit dhe rrezikut, të kemi njohuri lidhur me llogaritjen e çmimit të emetimit të obligacioneve, të aplikohen standardet dhe rregullat për obligacionet në datën e lëshimit deri në maturim, të kuptojmë lidhur me çështjet e përfshira në strukturimin e qirasë dhe kontabilitetin e tij, të kemi njohuri lidhur me komponentet më të zakonshme të kapitalit aksionar dhe ngjarjeve që ndryshojnë kapitalin aksionar (si t'i llogarisim ato) si dhe t'i analizojmë ndikimin e opsioneve të aksioneve në të ardhurat e raportuara. Poashtu, ndjekja e kësaj lënde mundëson ndërtimin praktik të pasqyrës së rrjedhës së parasë sipas dy metodave si dhe interpretimin e aktivitetetve ekonomike të përfshira.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Studentët të cilët do ta ndjekin këtë lëndë, paraprakisht kanë njohuri mbi bazat e kontabilitetit. Pas kompletimit të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje të: - Të përshkruajnë natyrën dhe qëllimin e kontabilitetit financiar; - Të njohin dhe regjistrojnë transaksionet ekonomike që lidhen me pasuritë afatgjata; - Të njohin dhe regjistrojnë transaksionet ekonomike që lidhen me detyrimet afatshkurtëra; - Të njohin dhe regjistrojnë transaksionet ekonomike që lidhen me detyrimet afatgjata, përfshirë mënyrën e kalkulimit dhe regjistrimit të dëftesave të pagueshme, qirasë (lizingut) së pagueshme dhe hipotekës së pagueshme; - Të kenë njohuri lidhur me format e financimit të korporatave; - Të njohin dhe kontabilizojnë metodat për kalkulimin e obligacioneve të pagueshme në datën e emetimit; - T'i njohin komponentet e kapitalit aksionar dhe të kryejnë kontabilizimin e aksioneve, dividendës dhe fitimit të mabjtur;

	- Të ndërtojnë dhe interpretojnë pasqyrën e rrjedhës së parasë me dy metoda dhe ta arsyetojnë dobishmërinë e saj për përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike	1	15	15
Ushtrime praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare	1	5	5
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			30
Përgatitja përfundimtare për provim			25
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)			
Projektet, prezantimet, etj	5	1	5
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies:	Procesi i mësimdhënies kryesisht do të mbështetet në metodën biseduese dhe argumentuese. Kjo metodë supozon se studentët paraprakisht janë të vetëdijshëm për temën që do të shtjellohet dhe vijnë të përgatitur në klasë. Këto do të realizohen në aspektin teorik dhe praktik, duke ofruar njohuri të përgjithshme shkencore, bazuar në literaturën bashkëkohore. Ndërkaq, pjesa praktike kryesisht do të realizohet përmes shembujve konkret nga literatura dhe nga njohuritë praktike të zhvillimit të aktivitetit ekonomik të njërive ekonomike. Në këtë mënyrë do të synohet krijimi i raporteve ndërvepruese profesor–student si dhe ai student-student.		
Metodat e vlerësimit:	Nota finale do të bazohet në shpërndarjen e mëposhtme: Vlerësimi i parë periodik nga lënda: 30% Vlerësimi i dytë periodik nga lënda: 50% Detyra dhe prezantime/seminare: 10% Participime dhe angazhime: 5% Vijueshmëria: 5% Provimi final <u>Vlerësimet periodike</u> : pritet që ju të merrni pjesë në vlerësimet sipas kohës së planifikuar. <u>Detyra dhe prezantime/seminare</u> : kërkohet që ju të merrni pjesë në projektet e grupit. Gjithë grupi duhet të kontribuojë në prezantimet e njëri-tjetrit, në mënyrë që t'i shprehni pikëpamjet tuaja lidhur me çështjet për diskutim. Pjesëmarrja e rregullt në diskutime dhe të qenit aktiv do të ju mundësojë të merrni edhe 5% bonus në vlerësimin përfundimtar. <u>Vijueshmëria</u> : pjesëmarrja e rregullt në ligjërata do të konsiderohet si kritike. Maksimumi i ligjëratave që ju do t'i humbni dhe akoma do ta merrni 5% është dy. Shkallët e notave:		

		91-100% nota 10 (dhjetë)
		81-90% nota 9 (nëntë)
		71-80% nota 8 (tetë)
		61-70% nota 7 (shtatë)
		51-60% nota 6 (gjashtë)
		50-me pak nota 5 (pesë)

Literatura

Literatura bazë:	Skender Ahmeti, Prof.Dr., Kontabiliteti Financiar, (koncepte themelore)” Prishtinë, 2012 Rrustem Asllanaj, Prof.asoc.Dr., Kontabiliteti financiar”, Prishtinë, 2013
Literatura shtesë:	Shfrytëzoni SEMS-in për materialet e vendosura nga bartës i lëndës Harrison, Horngren, Thomas, Financial Accounting, 9th edition. Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit

Plani i dizajnuar i mësimi:

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje në kontabilitetin financiar; Prezantimi i koncepteve themelore lidhur me kontabilitetin financiar.
Java e dytë:	Pasuritë afatgjata dhe klasifikimi i tyre; Kontabiliteti i pasurisë afatgjatë; Kalkulimi i kostos së tyre; Zhvlerësimi dhe metodat e llogaritjes së tij.
Java e tretë:	Kontabiliteti i detyrimeve afatshkurtëra; Detyrimet që njihen dhe vlerësohen me saktësi-furnitorët, dëftesat e pagueshme, dividendat e pagueshme, TVSH e pagueshme, detyrimet akruale.
Java e katërt:	Kontabiliteti i detyrimeve afatshkurtëra; Detyrimet që nuk njihen dhe vlerësohen me saktësi-detyrimet e vlerësueshme dhe detyrimet e rastit.
Java e pestë:	Kontabiliteti i detyrimeve afatgjata-huatë, dëftesat bartëse të interesit, hipoteka e pagueshme.
Java e gjashtë:	Qiratë (lizingu) dhe klasifikimi i tij; Evidenca kontabël e qirasë.
Java e shtatë:	Detyra praktike dhe shembuj lidhur me regjistrimin e transaksioneve ekonomike.
Java e tetë:	Vlerësimi i parë periodik nga lënda
Java e nëntë:	Obligacionet e pagueshme; karakteristikat e obligacioneve; llojet e obligacioneve; llogaritja e çmimit të obligacioneve dhe evidenca kontabël e emetimit të obligacioneve me vlerë emetuese dhe me prim; amortizimi i primit dhe veprimet rregulluese.
Java e dhjetë:	Obligacionet e pagueshme; evidenca kontabël e emetimit të obligacioneve me diskont dhe ndërmjet datave të interesit; Amortizimi i diskontit dhe veprimet rregulluese.
Java e njëmbëdhjetë:	Financimi i korporatës me aksione; Kontabiliteti i aksioneve të zakonshme dhe të preferuara; Kontabiliteti i aksioneve të thesarit.
Java e dymbëdhjetë:	Fitimi i mbajtur dhe dividendat; Evidenca kontabël e dividendës sipas llojeve.
Java e trembëdhjetë:	Kontabiliteti i ortakërive; financimi i kapitalit të ortakëritë. Ndërtimi i pasqyrës së rrjedhës së parasë dhe analiza e aktiviteteve ekonomike të përfshira.
Java e	Detyra praktike dhe shembuj lidhur me regjistrimin e obligacioneve me

<i>katërmëdhjetë:</i>	vlerë emetuese, me prim, diskont, regjistrimin e aksioneve dhe kontabilizimit të dividendës.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i dytë periodik nga lënda.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërate të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat që do t'u jepen. Studentët inkurajohen të përcjellin diskutimet në media dhe të hapin diskutime lidhur me to. Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat studimore. Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në ligjërata. Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e ID kartelës në teste dhe provim. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.	